

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMLORE NË GJILAN**, - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues – gjyqtarit Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit I. M. nga fshati H. Komuna e K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr.172/2016, të datës 29.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 20.10.2016, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë :

## **A K T G J Y K I M**

I akuzuari I. M., nga i ati S. dhe nëna Z., e lindur D., i lindur më datë ... në fshatin H., Komuna e K., ku edhe tani jeton, i martuar, baba i ... fëmijëve, i pa punë, ka të kryer shkollën e mesme ..., i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

## **Ë S H T Ë F A J T O R**

Se më datë ... .2016, rreth orës ... , me rastin e kontrollimit nga ana e Policisë së Kosovës, në pikën kufitare “...” automjetin e udhëtarëve të markës ... ngjyrë e ..., me tabela të regjistrimit ..., të cilën e drejtonte D. K., e në cilësi të pasagjerit ishte i akuzuari I. M. nga fshati H., ashtu që në ulësen e përparme të pasagjerit tani të akuzuarit I. është gjetur një paketim me ... copë municion te llojit “...” ...mm, pa prodhim nga Bosnja dhe Hercegovina, e që me rastin e kontrollimit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse pronë e të akuzuarit I. nga fshati H., Komuna e K., janë gjetur ... copë fishek cal. ... mm, për revole ... auto prodhim i Serbisë , ... fishek ... mm, për revole ... dhe një ... e armës e të cilat edhe i konfiskohen.

*Me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës*

*Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41, 46, 69, 73, 114, dhe 374 par. 3 të KPRK-ës, dhe nenit 365, 453 të KPPRK-ës.*

## **E G J Y K O N**

*Të akuzuarin I. M., me dënim me gjobë në shumë prej 300 (treqind) euro, të cilën gjobë i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën Gjykata do të ia zëvendësoi me dënim burgu ashtu që do të i llogaritet shuma prej 20 euro për një ditë burgimi.*

*Të akuzuarit i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i një paketimi me ... municion të llojit "... " ... mm, pa prodhim nga Bosnja dhe Hercegovina, e që me rastin e kontrollimit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse pronë e të dyshuarit I. nga fshati H., Komuna e K., janë gjetur ... copë fishek cal... mm, për revole ... auto prodhim i Serbisë , ... fishek ... mm , për revole ... dhe ... futroll e armës e të cilat edhe i konfiskohen.*

*Obligohet i akuzuari që ti paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 (njëzet e pesë) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

## **A r s y e t i m**

*Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti i Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I.nr.172/2016, të datës 25.07.2016, kundër të akuzuarit I. M.nga fshati H., Komuna e K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.*

*Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan Departamenti për krime të rënda Afrim Shefkiu, fillimisht mbeti pranë aktakuzës e më pas shtoi se pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, i propozoi gjykatës që të pandehurin ta shpalli fajtor dhe ta dënoi me dënim meritor. Me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh edhe rrethanat lehtësuese edhe ato rëndueses në mënyrë që dënimi të jetë në proporcion me peshën e veprës penale.*

*Mbrojtësja me autorizim i të akuzuarit I. M., avokate S. M. nga Gj., deklaroj se meqë i pandehuri e ka pranuar fajësinë mbrojtja nuk do të lëshohet në elaborimin e gjendjes faktike dhe juridike, ashtu siç përmban akuza por propozoi Gjykatës që me rastin e matjes së lartësisë së dënimit të marrë parasysht si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimin e fajësisë nga e të pandehurit dhe mbi këtë bazë të shqiptoi një dënim të arsyeshëm e më konkretisht propozojmë Gjykatës që ndaj të njëjtit të shqiptohet një dënim i kushtëzuar apo ndonjë dënim me gjobë e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që i pandehuri në të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale.*

*I akuzuari I. M., fillimisht e pranoi fajësinë për veprën e kryer penale dhe shtoi se përkrahu në tërësi fjalën e mbrojtëses - avokate S. M., i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale e di se kam gabuar me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale. Andaj, kërkoj nga Gjykata që të më shqiptoi një dënim sa më të but që është e mundur.*

*Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës veçanërisht formularë pranim dorëzimit i datës 21.07.2016, vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës ... .2016, vërtetimin për bastisjen e shtëpisë të datës ... .2016, foto dokumentacionin me 10 fotografi dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit erdhi në përfundim se i akuzuari I. M.ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës*

*Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysht rrethanat të parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, pati sjellje të mira në Gjykatë, premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, se është i gjendjes së dobët ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysht shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit të veprës penale dhe rrezikshmërinë shoqërore duke qenë se kjo sasi e municionit paraqet rrezik për popullatën, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPK-ës.*

*Vendimi mbi dënimin plotësues është bazuar në nenin 69 si dhe 374 par. 3 të KPRK-së ashtu që të akuzuarit i konfiskuar një paketim me .... cope ... municion te llojit "...” ...mm, pa prodhim nga Bosnja dhe Hercegovina, e që me rastin e kontrollimit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse pronë e të akuzuarit I.M., janë gjetur ... copë fishek cal. ... mm, për revole ... prodhim i Serbisë , ... fishek ... mm , për revole ... dhe ... futroll e armës.*

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.*

*Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA  
PKR.nr.183/2016 Me datë 20.10.2016**

**Sek. Juridike,**  
Naile Neziri

**Kryetari i trupit gjykues,**  
Agim Ademi

**KËSHILLA JURIDIKE**, kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.